

PROTOKOLL BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

TEATRIT KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

DREJTORISË SË PËGJITHSHME TË OPERAS DHE BALETIT SHTETËROR TË MINISTRISË SË KULTURËS DHE TURIZMIT TË REPUBLIKËS SË TURQISË

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Operas dhe Baletit Shtetëror të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë (referuar individualisht si “Palë” dhe sëbashku si “Palët”)

Duke dëshiruar të zgjerojnë dhe përmirësojnë bashkëpunimin artistik dhe kulturor midis Palëve,

Duke besuar se parimet e mëposhtme do të shërbejnë si një kornizë e qëndrueshme për bashkëpunimin me përfitime të përbashkëta,

Bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij protokoll bashkëpunimi është krijimi i kushteve për realizimin e përbashkët të performancave të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor të Republikës së Shqipërisë në skenën e Drejtorisë së Përgjithshme të Operas dhe Baletit Shtetëror të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë, dhe anasjelltas.
2. Palët marrin pjesë në produksione të përbashkëta të performancave, shkëmbime autorësh, artistësh dhe profesionistësh të ndryshëm dhe në firma të tjera bashkëpunimi në punët e teatrit të cilat janë në interes të dy palëve.
3. Ky Protokoll Bashkëpunimi është lidhur me synimin për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet Palëve dhe nuk përbën një marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme për shtetet e pjesëmarrësve sipas ligjit ndërkombëtar. Asnjë dispozitë e këtij Protokoll Bashkëpunimi nuk do të interpretohet dhe zbatohet si krijimi i të drejtave ose angazhimeve ligjore për Shtetet e Palëve.

Neni 2

Projektet e përbashkëta

Palët angazhohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellët të promovojnë njëra-tjetrën në lidhje me shfaqjet e trupave në festivale apo projekte të tjera teatrore, në kuadër të realizimit të programeve dhe veprimtarive të tyre.

Neni 3

Kushte të përgjithshme për shkëmbim shfaqjesh

1. Palët informojnë njëra – tjetrën për afatet e realizimit të produksioneve, nevojat programet e tyre artistike dhe mundësitë e realizimit të tyre.
2. Forma, kohëzgjatja dhe kushtet financiare të shkëmbimit për realizimin e produksioneve artistike do të zbatohen mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellët dhe do të dakordësohen ndërmjet palëve.

Neni 4

Zbatimi i Protokollit

Çdo aktivitet i kryer sipas këtij protokoll, nga cilado nga Palët, do të bëhet në përputhje me ligjet rregulloret dhe procedurat e brendshme të palës përkatëse.

Neni 5

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi i këtij Protokollit për Bashkëpunim do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe do të mbetet i vlefshëm për një periudhë (1) vjeçare. Nëse njëra Palë nuk e njofton tjetrën me shkrim me qëllimin për ta përfunduar këtë Protokoll Bashkëpunimi gjashtë (6) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së tij, ky Protokoll Bashkëpunimi do të zgjatet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme (1) vjeçare.
2. Secila Palë mund të përfundojë këtë Protokoll Bashkëpunimi në çdo kohë duke njoftuar me shkrim Palën tjetër për këtë qëllim. Në këtë rast, Protokollit i Bashkëpunimit do të ndërpritet gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

3. Ky Protokoll Bashkëpunimi mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve në çdo kohë. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë të parashikuar në pikën 1 të këtij Neni.
4. Përfundimi i këtij Protokoll të Bashkëpunimit nuk do të ndikojë në zbatimin e ndonjë aktiviteti në vazhdim, përveçse nëse Palët vendosin ndryshe me shkrim.

Nënshkruar në Tiranë, më 17/01/2022, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet kanë vlefshmëri të njëjtë. Në rast mosmarrëveshje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR TEATRIN KOMBËTAR TË
OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Elya Margariti
Ministër i Kulturës



**PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË OPERAS DHE BALETIT
SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË
TURQISË**

Mehmet Nuri Ersoy
Ministër i Kulturës dhe Turizmit



COOPERATION PROTOCOL

BETWEEN

**THE NATIONAL THEATER OF OPERA, BALLET AND FOLK ENSEMBLE
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

AND

**THE DIRECTORATE GENERAL OF STATE OPERA AND BALLET OF THE
MINISTRY OF CULTURE AND TOURISM OF THE REPUBLIC OF TURKEY**

The National Theater of Opera, Ballet and Folk Ensemble of the Republic of Albania and the Directorate General of State Opera and Ballet of the Ministry of Culture and Tourism of the Republic of Turkey (hereinafter referred to individually as "Participant" and together as "Participants")

Desiring to establish and develop artistic and cultural cooperation between the Participants,

Believing that the following principles will serve as a viable framework for mutually beneficial cooperation,

Have reached the following understanding:

Paragraph 1

PURPOSE

- The purpose of this Cooperation Protocol is to forge / establish the conditions for the joint execution of the performances of the National Theater of Opera, Ballet and Folk Ensemble of the Republic of Albania on the stage of the Directorate General of State Opera and Ballet of the Ministry of Culture and Tourism of the Republic of Turkey, and vice versa.
- The Participants participate in joint productions of performances, exchanges of authors, artists and other professionals, and in other forms of cooperation in theater affairs, which are in the interest of both Participants.
- This Cooperation Protocol is concluded with a view to enhancing and developing cooperation between the Participants and does not constitute an international agreement binding upon the States of the Participants under international law. No provision of this Cooperation Protocol will be interpreted and implemented as creating legal rights or commitments for the States of the Participants.

Paragraph 2

JOINT PROJECTS

The Participants will be committed, on the basis of reciprocity, to promote each other's troupe performances at the festivals, events or other theater projects, in the framework of carrying out their programs and activities.

Paragraph 3

GENERAL CONDITIONS FOR THE EXCHANGE OF PERFORMANCES

- The Participants will inform each other about the deadlines for the realization of the productions, their needs, their artistic programs, and the opportunities of carrying them out.
- The forms, duration and financial conditions of the exchange for carrying out the artistic productions will be implemented on the basis of reciprocity and will be decided between the Participants by making additional contracts.

Paragraph 4

IMPLEMENTATION OF PROTOCOL

The activities under this Cooperation Protocol will be carried out in accordance with the respective national legislations of the Participants.

Paragraph 5

DISPUTES

Any dispute that may arise from the interpretation of this Cooperation Protocol will be settled amicably between the Participants.

Paragraph 6

COMING INTO EFFECT

1. This Cooperation Protocol will come into effect upon signature and remain valid for a period of one (1) year. Unless one of the Participants notifies the other in writing of its intention to terminate this Cooperation Protocol six (6) months prior to expiration of its validity, this Cooperation Protocol will automatically be extended for successive periods of one (1) year.

2. Each Participant may terminate this Cooperation Protocol at any time by giving to the other Participant a written notification to that effect. In this case, the Cooperation Protocol will be terminated six (6) months after the date of the receipt of the notification.

3. This Cooperation Protocol may be amended by mutual written consent of the Participants at any time. The amendments will come into effect with the same procedure prescribed under the first subparagraph of this Paragraph

4. The termination of this Cooperation Protocol will not affect the implementation of any ongoing activities, unless both Participants decide otherwise in writing.

Signed in duplicate at Tirana, on 17/01/2022, in the Albanian, Turkish and English languages, all texts having equal validity. In case of any divergence in interpretation, the English text will prevail.

**FOR THE NATIONAL THEATER
OF OPERA, BALLET AND FOLK
ENSEMBLE OF THE REPUBLIC OF
ALBANIA**



Elva Margariti
Minister of Culture

**FOR THE DIRECTORATE
GENERAL
OF STATE OPERA AND BALLET**



Mehmet Nuri Ersoy
Minister of Culture and Tourism